



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 16333
U. Br.

Nr. 16333
Br. 13 Data: 21.07.
Br. str. KAMENICËA Datum: 2025.

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KM653-25-1640-2-1-1/C703

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë^{anët} faq.
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik „VARNA SH.P.K.; Rinesa SH.P.K., katundi i ri, Kamenica, (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Pastrimi i lumenjëve dhe përrockave me numër identifikues: KM653-25-1640-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Sipas pershkrimit te çmimve dhe dosjes se tenderit

Nr.	Grupi
1	Pastrimi i lumenjëve dhe përrockave

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasi e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 01.07.2025dhe perfundon në datën 31.06.2027

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Sipas kërkesave te njësisë kerkuese

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është **150,000.00** Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është nuk lejohet

3.2 Çmimi i përmendor në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Urim Thaqi	Emri:	Ragip Lenjani
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.07.2025	Data:	01.07.2025
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroesit e Shërbimeve në pajtim me Specififikimet dhe Përskrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofroes i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVKE.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç të këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroesit të Shërbimeve siguruesve të Ofroesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar hunibjen ose dëtyriimin e Ofroesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç të raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofroresi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroresi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, këu e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishni akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Ménaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofroresi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofroresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vónohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofroresi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshtësia ndërmjet ofroresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofresin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhë nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanj e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofresi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi përtë realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes përt pagesat e vonuara, përmosrealizim ose përdërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit përtë kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cilë mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofresi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është rraja praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative përtë plotësuar ndonjë të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofresit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofresi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëmi të paralajmërit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim përtë realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë seriøze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofresi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhënë nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofresi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofresi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pëzelluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rrëgulloret nacionale;
- (e) Ofresi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofresi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqë jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto mëdifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapë të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutiimin e shërbimëve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhën Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhën në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspoziuar dënimt për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofroesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofroesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marrë në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofroesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Persóni i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontratë do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofroesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofroesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofroesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofroesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjerë të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'ë marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofroesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekijn detyrimet e Ofroesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofroesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofroesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofroesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofroesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguaje

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se është e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të sakta sohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas leshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i reportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitiim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të inuajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbyt detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të janë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është së shumti definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekzekutimi që llogaritet së përshtruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë së shumtë cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të siperpërmendura, mund të jepen dëmshpërbime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zëritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofriuesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekë për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohën ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkëses për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkëses. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofriuesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimishme nga ana e ofriuesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofriuesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofriuesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofriuesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen përfunditë gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>Vendim i ZKA-së</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>15.000.00€ me kohëzgjatje deri me date 31.07.2027</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të janë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë [<i>sheno shumen</i>] b) Përgjegjësia e pales së tretë [<i>sheno shumen</i>] c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve [<i>sheno shumen</i>] d) Përgjegjësia profesionale [<i>sheno shumen</i>] e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve [<i>sheno shumen</i>]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve do të bëhet ne mëste AK dhe Opereatorit ekonomik.	20.2	Kontrata lidhet sipas vlerës se parashikuar. Varesishte prej mijeteve ne dispozicion do të kryhen edhe punët.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. Ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.




Pasqimi i lumenjave dhe perekekteve

Shenimi: Per tu vertetuar sasia e germuar apo e mbushur e dheut, aluvionit, zhavoreve, O.E. duhet te angazhoj gjeddet te licensuar, qe ti beje matjet gjeodezike te gjendjes pas intervenimit, i cili duhet ti llogarise ndryshimet ne sasi, ashtu qe te dihet shkaktesisht sasia e germuar apo e mbushur.

PJESA 1	Nr	Përshtikimi i pozicioneve	Njësia /Mafëse	Sasia	Gjimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (me TVSh)-€
1	1	Largimi i mbeturinave të ngurta (mbeturinat e amvisëris dhe materialat e tjera inerte) nga shtretërit e lumenjeve dhe transporti në deponinë komunale.	m3	1	10.00	10.00
2	2	Gërmimi - largimi i aluvionit të grumbulluar me qëllim të zgjerimit dhe themelimit të kanaleve te hapura atmosferike (formilimin i profilit "V"). Ne rastet kur ne vendin e intervenimit ka drunjë shkurre, te behet Prejja e drureve, shkurreve dhe bartja deri ne deponi brenda territorit te Komunes qe caktohet nga AK	m3	1	15.00	15.00
3		Intervenimi dhe çbllokim i leshesave ekzistuese gjypore, dhe gjypave te kanalizimit atmosferik, permës makinerise speciale me presion se paku 250 Bar, deni ne funksionalizim te plotë te leshesave dhe gjypave (testimi per kalim te lire te ujfareve nga njera ane ne tjetren te behet ne prani te A.K.).	m ³	1	2.00	2.00

	Furnizimi, transporti dhe punimi i gardhit, nga profillet e qelikut te galvanizuar (zinkim ne te nxente), ku 2 horizontalet (siper dhe poshte) dhe shtyllat (cdo 2.0m largesi) punohen me profile 50x50x3mm. Mbushja te punohet me profile 30x10x2mm cdo 11cm. Ankerimi i shtyllave behet ne beton, permes pilakave metalleke 150x150x8mm edhe 4 ankerat M12 L140mm. Ne cmim te perfshihet, pastrimi i punishes nga mbetjet, eji, saldimet, te jene sipas standardeve te sigurise, gjithashu edhe skajet e posfilleve te jene te gryera dhe te rumbullakosura simbrojte per perduresit. Lartesia e gardhit sipas kerkeses se AK. (qe mvareshiqt nga rezzikshmeria e pozicionit mund te jetë nga 100 deri ne 120 cm). Ligarija behet me meter-katrose te hapesisres se gardhit.	4	m2	1	90.00	90.00
	Furnizimi, transporti dhe punimi i gardhit, nga profillet e mbrojtura kunder ndryshkut me 2x imbrojje Minium dhe 2x ngyire, ku 2 horizontalet (siper dhe poshte) dhe shtyllat (cdo 2.0m largesi) punohen me profile 50x50x3mm. Mbushja te punohet me profile 30x10x2mm cdo 11cm. Ankerimi i shtyllave behet ne beton, permes pilakave metalleke 150x150x10mm edhe 4 ankerat M12 L140mm. Ne cmim te perfshihet, pastrimi i punishes nga mbetjet, eji, saldimet, te jene sipas standardeve te sigurise, gjithashu edhe skajet e posfilleve te jene te gryera dhe te rumbullakosura simbrojte per perduresit. Lartesia e gardhit sipas kerkeses se AK. (qe mund te jetë nga 100 deri ne 120 cm). Ligarija behet me meter-katrose te hapesisres se gardhit.	5	m2	1	85.00	85.00
	Furnizimi, transporti dhe punimi i gardhit, nga profillet e qelikut te galvanizuar (zinkim ne te nxente), ku 2 horizontalet (siper dhe poshte) dhe shtyllat (cdo 2.0m largesi) punohen me profile 80x80x2.5mm. Mbushja te punohet me profile 40x30x2mm cdo 11cm. Ankerimi i shtyllave behet ne beton, permes pilakave metalleke 180x150x10mm edhe 4 ankerat M12 L140mm. Ne cmim te perfshihet, pastrimi i punishes nga mbetjet, eji, saldimet, te jene sipas standardeve te sigurise, gjithashu edhe skajet e posfilleve te jene te gryera dhe te rumbullakosura simbrojte per perduresit. Lartesia e gardhit sipas kerkeses se AK. (qe mvareshiqt nga rezzikshmeria e pozicionit mund te jetë nga 100 deri ne 120 cm). Ligarija behet me meter-katrose te hapesisres se gardhit.	6	m2	1	90.00	90.00

	Furnizimi, transporti dhe punimi i gardhit, nga profilat e mbrojtura kunder ndryshkut me 2x mbrojte Minium dhe 2x ngjyre, ku 2 horizontal (siper dhe poshtë) dhe shyllat (cdo 2.0m largësi) punohen, me profile 80x60x2.5mm. Mbushja te punohet me profile 40x30x2mm cdo 11cm. Ankerimi i shyllave, behet ne beton, permes plakave metallike 180x160x10mm edhe 4 ankerat M12-L140mm. Ne cmim te perfshihet, pastimi i punishtes nga mbetjet, etj, saidimet, te jene sipas standardeve te sigurise, gjithashu edhe skajet e profileve te jene te gryera dhe te rumbullakosura si mbrojte per perdonuesit. Lartesa e gardhit sipas kerkeses se AK. (qe mund te jetë nga 100 deri ne 120 cm). Llogarija behet me metri katror te hapesires se garchit.	m2	1	9.00	9.00
7	Furnizimi, transporti dhe punimi i hunjeve metalik, me lartesi 1m, nga proflet e qeliku te galvanizuar (zinkim ne te nxehet), ku profili eshte rrjetor Ø90-Ø100. Llogarit qe ankerimi te behet ne beton te lagesht 30x30x30cm. Ne cmim. te perfshihet, pastimi i punishtes nga mbetjet, etj. Llogarija behet ne scop.	copë	1	2.00	2.00
8	Furnizimi, transporti dhe punimi i pjesave nga betoni, si elemente shtese per parandalimin e erozionit-derrimit te mureve ekzistuese dhe te urave, neper vendet ku paraqitet nevoja per riparim. elementet punohen nga betoni C30/37, me dimensione te ndryshme. Ne cmim te llogariten edhe shallonat. Llogarija behet me meter kub te betonit, ndersa armimi llogaritet 100kg armature per m3 te betonit	m3	1	2.00	2.00
PJESA 1 TOTALI PERGJITHSHEM ME TVSH:					305.00

<p>Mbijellja e drunjive te llojit "Shelg" per te parandaluar erozinin e shtreteve te lumenejeve dñe perrockave, Per detaje referojuni detajit. Dimensionet e mbjelljes percaktohen nga A.K</p>  <p>10</p>	<p>copë / fidane</p> <p>1</p> <p>2.00</p> <p>2.00</p>	<p>Dhenja ne shfrytëzim te mureve "L" (vinkell), nga betoni me trashesi se paku 10cm, më lantesi 1.0m-1.5m, duke illogaritur transportin, imontimin, demontimin, ne lokacionin qe e caktion A.K.</p> <p>Furnizimi, transporti dhe vendosja e ujëlëshesave nga gypat HDPE S/N8 me diameter si me poshtë, ne cmim te Illogaritet, germimi, mbushja me rreth gypit, mbushja dhe ngeshja e zhavorit 0-31.5mm mbi gyp me trashesi se paku 20cm, dhe rrashimi i hapesires rreth kanalit:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>m1</th> <th>1</th> <th>1.00</th> <th>1.00</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>12 Ø 315</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>25.00</td> <td>25.00</td> </tr> <tr> <td>13 Ø 400</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>40.00</td> <td>40.00</td> </tr> <tr> <td>14 Ø 500</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>60.00</td> <td>60.00</td> </tr> <tr> <td>15 Ø 600</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>85.00</td> <td>85.00</td> </tr> <tr> <td>16 Ø 800</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>120.00</td> <td>120.00</td> </tr> <tr> <td>17 Ø 1000</td> <td>m1</td> <td>1</td> <td>210.00</td> <td>210.00</td> </tr> </tbody> </table>		m1	1	1.00	1.00	12 Ø 315	m1	1	25.00	25.00	13 Ø 400	m1	1	40.00	40.00	14 Ø 500	m1	1	60.00	60.00	15 Ø 600	m1	1	85.00	85.00	16 Ø 800	m1	1	120.00	120.00	17 Ø 1000	m1	1	210.00	210.00
	m1	1	1.00	1.00																																	
12 Ø 315	m1	1	25.00	25.00																																	
13 Ø 400	m1	1	40.00	40.00																																	
14 Ø 500	m1	1	60.00	60.00																																	
15 Ø 600	m1	1	85.00	85.00																																	
16 Ø 800	m1	1	120.00	120.00																																	
17 Ø 1000	m1	1	210.00	210.00																																	

Furnizimi, transporti dhe vendosja e ujëlëshesave nga gypa BA me diameter si me poshtë, në cmim te illogaritet, germimi, mbushja me rreth gypit, mbushja dhe ngjeshta e zhavorit 0-31.5mm mbi gyp me trashesi se paku 20cm, dhe trafshimi i hapestires rreth kanalit:

18	Ø 400		m1	1	30.00	30.00
19	Ø 500		m1	1	40.00	40.00
20	Ø 600		m1	1	60.00	60.00
21	Ø 800		m1	1	80.00	80.00
22	Ø 1000		m1	1	120.00	120.00
PJESA 2 TOTALI PËRGJITHSHEM ME TVSH:					873.00	

REKAPITULIMI						
1	PJESA 1			305.00	0.7	213.50
2	PJESA 2			873.00	0.3	261.90
		totali i peshuar				475.40

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Varna shpk
EMRI DHE NBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Rajip Lenjani
NËNSHKRIMI:	<i>D. Rajipi</i>
DATA:	23.04.2025
VULÀ:	K





Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithëka që duhet ta keni

Deklarate e Garantuesit

SIGURIAJE EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 140659

Për Kuvendi Komunal Kamenicë

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emrin e VARNA SH.P.K.

(Emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nj. i biznesit në vazhdim Operatorit Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Pastrimi i lumenjëve dhe përrro�kave

Nr. prokurimit: KM653-25-1640-2-1-1

Garancion me kërkese të parë

Derisa operatori ekonomik i iartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një sigurilë ekzekutimil duke i u referuar dosjes se tenderit me numerin e prokurimit të iartërekuar të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhengase tenderuesit deshiron te depozitor garancine ne shumën e saktësuar ne dosjen e tenderit, dhengase jemi pajtuar t'i lapijm tenderuesit këtë garantzi. Andaj me këtë konfirmojme se jemi garantuesi dhe per glegjës para jush, ne emrin e operatorit ekonomik deri nën një shume totale 15,000,00€ zotohem i teju pagualjmë, që me kërkeshen tuaj të pare me shkrim në të cilin deklarohet mosperputhja e injerit nga kushtet ne vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të deshmivë të vertetuarë objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nenshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoriteti kontraktues të dështuar që të ekzekutojë kontratën e nenshkruar dhe si rezultati i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtore, nuk kontraktorë dhe/o se furnizues te materialëve.
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nenshkruar dhe si rezultati i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtore, nuk kontraktorë dhe/o se furnizues te materialëve.

Pagesa në shumën e limituar prej 15,000,00€ është iartëcekur, pa pasur nevoje të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaket e kërkeshës tuaj, apo per shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 760 ditë kalendarike prej 01.07.2025 deri me 31.07.2027. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kallon e drejtë përlatërimbursuar nga i Siguruar/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përbushjen e terësisht me detyrimeve.

Data i shkrimit: 01.07.2025
Nenshkrimi dhe vula e garantuesit:



Ky garacion i nënshtronhet rregullave uniforme për garancione (UHDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tirana Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kelsig.com

Gjithcka që duhet ta keni



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: 140659

Kontraktuesi		Lënda e Garancisë
Emri	VARNA SH.P.K.	Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:
Përfaqësuar nga	Ragip Lenjani	1. Mbëshitetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësoje çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
Adresa	Katundi I RI	2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërbillimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
Nr i Biznesit	810112954	3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mijetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
Telefoni	044183570	4. Ky sigurim është lidhur sipas kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
Përfituesi		5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) si dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)
Emri	Kuvendi Komunal Kamenicë	
Adresa	Kamenicë	
Garantuesi		
Emri	Elsig	
Banka	NLB	
Mbulueshmërla e Polices		
Shuma Siguruar	15,000.00	
Perludha Sigurimit	01.07.2025 - 31.07.2027	
Primi	562.19	
Tvsh.	101.19	
Primi Bruto	663.39	
Data e lëshimit	01.07.2025 09:12	
Aktiviteti Ekonomik: Pastrimi i lumenjëve dhe përrrockave		

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtimi/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar përimin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the Insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Besnik Hajdini - 4449



Përfaqësuesi i të siguruarit
Ragip Lenjani